

## **Prof. Dr. Izet Zeqiri**

### **Prorektor për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore**

**Izet Zeqiri, është** lindur në Kaçanoll të Komunës së Mitrovicës, në vitin 1970. Është profesor i rregullt në Fakultetin e Gjesohkencave. Studimet themelore dhe ato postdiplomike i ka kryer në Mitrovicë, ndërsa ka doktoruar në Universitetin Politeknik të Tiranës në vitin 2004.

Në vitin 1995 ka nisur punën në Universitetin e Prishtinës. Vazhdimisht ishte i angazhuar në studimet themelore, master dhe të doktoraturës në fushat që janë të lidhura ngushtë me teknikën minerare, metodat matematikore në inxhinierinë operacionale si dhe aplikimet kompjuterike, ndërsa nga viti 2014 është i angazhuar edhe në Fakultetin Ekonomik dhe atë të Edukimit në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Ka kaluar nëpër të gjitha fazat e avancimit, që nga bashkëpunëtori profesional gjer tek profesori i rregullt (2012). Deri më tani, si autor/koautor ka publikuar mbi 60 punime shkencore dhe profesionale në revistat vendore dhe ndërkombëtare, 2 tekste universitare dhe 6 dispensa.

Në rolin e mentorit, apo kryetarit/anëtarit të komisionit, rreth 30 kandidatë kanë mbrojtur temën e magjistraturës dhe masterit si dhe 9 kandidatë temën e doktoratës. Ka qenë shumë herë në komisione për nostrifikim, njohje – barasvlerësim të tri doktoratave, të cilat janë mbrojtur jashtë shtetit si dhe recensent i 8 punimeve shkencore ndërkombëtare. Ka mbaruar disa trajnime me rëndësi të veçantë për mësimdhënie si dhe ka punuar një numër revizionesh profesionale. Me përkushtim ka arritur të sigurojë kombinim të mirë të punës teorike dhe asaj praktike në aspektin e hulumtimeve profesionale dhe shkencore.

Gjatë viteve (1997-2004) ishte shef i departamentit të Xehetarisë, (2004-2009), Prodekan për Çështje të Studimeve në FXM, ndërsa nga vitet (2009 - 2013) dekan i Fakultetit të Gjesohkencave dhe Teknologjisë. Në vitin 2013 ishte anëtar i Këshillit themelues i Universitetit Publik të Mitrovicës, ku në të njëjtin vit është emëruar ud – Prorektor për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Në vitin 2015 është zgjedhur Prorektor për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, në Universitetin “Isa Boletini”. Jeton në Mitrovicë.